

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6558
E hënë, 14 mars 2022
çmimi 0.40

Veteranët kërkojnë t'u rriten pensionet

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ISH-MINISTRI I DREJTËSISË KËRKON MBYLLJEN E GJYKATËS SPECIALE

FAQE 4-5



Ish-ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se Kosova në bashkëveprim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-në) dhe Bashkimin Evropian (BE-në) duhet t'i fillojnë konsultimet me kërkesën për procesin e përmbylljes së Gjykatës Speciale në Hagë. Ai ka theksuar se Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet të fillojnë së vepruari e t'i iniciojnë përpjekjet institucionale për ndryshimet ligjore të nevojshme me qëllim të përmbylljes së kësaj gjykate të fabrikuar në Moskë e Beograd

OPINION

KULTURA E DIALOGUT DHE E ARDHMJA E KOSOVËS F.7

Milazim KRASNIQI



Fjalim në Muzeun Kosova në Vlorë, me rastin e promovimit të librit të Bedri Islamit "Triada e Kosovës"

MUZEU I KOSOVËS NË VLORË NGJARJE KOMBËTARE F.6



Ismet SYLEJMANI

AKTUALE



EURODEPUTETI BULLGAR: ËSHTË KOHA QË BE-ja T'I HEQË VIZAT PËR KOSOVËN F.3

SINDIKATAT DALIN KUNDËR QEVERISË, KËRKOJNË QË PAGA MINIMALE TË JETË 400 EURO F.3

EKONOMI

A DO TA RITEN PRODHIMIN SUBVENCIONET? F.8

BOK-ja: EKONOMIA E KOSOVËS NDIEN KRIZËN ME RITJEN E ÇMIMEVE F.8

KIEVI DHE MOSKA PARALAJMËROJNË REZULTATE POZITIVE NË BISEDIMET PËR LUFTËN NË UKRAINË



KRASNIQI TAKON NË HAGË THAÇIN DHE VESELIN: TË FORTË DHE KRENARË PËR LIRINË E KOSOVËS

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kievi dhe Moska paralajmërojnë rezultate pozitive në bisedimet për luftën në Ukrainë

KIEV, 13 MARS - Zyrtarët ukrainas dhe ata rusë kanë shprehur optimizëm për bisedimet që po zhvillojnë për luftën në Ukrainë, duke sugjeruar se mund të ketë rezultate pozitive brenda ditësh. Ukraina tha se është e gatshme për negociata, por nuk do të pranojë asnjë ultimatum. “Në parim ne nuk do të pranojmë asnjë lëvizje qëndrimi. Rusia tashmë e kupton këtë. Rusia veçse ka nisur të bisedojë në mënyrë konstruktive”, tha negociatori ukrainas, njëherësh këshilltar i presidencës, Mykhailo Podolyak. “Mendoj se do të arrijmë disa rezultate brenda ditësh”, tha ai përmes një video-mesazhi.

Ndërkaq, agjencia e lajmeve ruse RIA ka cituar zyrtarin e delegacionit rus, Leonid Slutsky, të ketë thënë se në bisedime është arritur përparim substancial. “Sipas pritjeve të mia personale, ky përparim mund të rritet në ditët e ardhshme dhe të arrihet deri te

Zyrtarët ukrainas: Mbi 2 100 banorë të Mariupolit janë vrarë

Këshilli i qytetit të Mariupolit tha se 2 187 banorë janë vrarë deri më tani. Ky qytet, që është rrethuar nga trupat ruse, po përballet me bombardime të vazhdueshme, duke lënë banorët pa furnizime thelbësore për pothuajse dy javë.

Zyrtarët lokalë thanë se një ditë më parë të paktën 22 sulme ajrore ruse kanë goditur qytetin. “Banorët janë në një situatë të vështirë tash e 12 ditë. Nuk ka rrymë, ujë, apo ngrohje në qytet. Po ashtu, nuk ka pothuajse as komunikime telefonike. Furnizimet e fundit me ushqim dhe ujë janë duke u harxhuar”, tha këshilli i qytetit përmes një deklarate. Forcat ruse kanë arritur ta marrin kontrollin e pjesës lindore të periferisë së Mariupolit.



një qëndrim i përbashkët i të dy delegacioneve, duke nënshkruar edhe dokumente”, tha Slutsky. Asnjëra palë nuk ka treguar se për çfarë marrëveshje bëhet fjalë.

Podolyaka tha se Rusia po dëgjon me kujdes propozimet e Ukrainës. “Kërkesat tona janë: dhënia fund e luftës dhe tërheqja e trupave ruse. E shoh se ata po e kuptojnë këtë dhe ky është dialogu”, tha ai.

Ukraina dhe Rusia kanë zhvilluar tri raunde bisedimesh në Bjellorusi. Kryediplomatët e të dy shteteve janë takuar, po ashtu, në Antali të Turqisë. Palët po bisedojnë edhe përmes platformave online, kanë bërë me dije më 12 mars zyrtarët ukrainas.

Ndërkaq, sipas imazheve satelitore, të publikuara së fundmi, në këtë qytet granatimet dhe bombardimet ruse kanë shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturën civile.

Forcat ruse kanë rrëmbyer kryetarin e qytetit Dnjiprorudne

Forcat ruse kanë rrëmbyer kryetarin e qytetit jugor, Dnjiprorudne, ka thënë ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba.

Yevhen Matveyev mund të jetë kryetari i dytë ukrainas që dyshohet se është rrëmbyer, pasi njëjtë është raportuar të ketë ndodhur edhe me kryetarin e Melitopolit.



Kuleba ka thënë se “kriminelët rusë të luftës” kanë rrëmbyer Matveyevin. “Sot kriminelët rusë të luftës rrëmbyen një tjetër kryebashkiak ukrainas të zgjedhur në mënyrë demokratike, kreun e Dniprorudne Yevhen Matveyev. Duke marrë zero mbështetje lokale, pushtuesit kthehen në terror. U bëj thirrje të gjitha shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që ta ndalojnë terrorin rus kundër Ukrainës dhe demokracisë”, ka shkruar ai në “Twitter”.

Presidenti polak: Përdorimi i armëve kimike mund të nxisë intervenim të NATO-s

Përdorimi i armëve kimike nga Rusia në Ukrainë mund të nxisë NATO-n ta rishqyrtojë vendimin e saj për të mos intervenuar në konflikt, ka thënë presidenti polak Andrzej Duda për transmetuesin britanik BBC.

I pyetur nëse beson se presidenti rus Vladimir Putin mund të jetë duke u përgatitur për përdorim të armëve kimike, Duda ka thënë se “kjo është diçka që bota nuk e ka parë në këtë shkallë prej Luftës së Dytë



Të paktën 35 viktima në bazën ushtarake në Javoriv

Të paktën 35 persona kanë vdekur dhe 134 të tjerë janë plagosur si pasojë e sulmeve ajrore ruse në një bazë ushtarake të Ukrainës afër kufirit me Poloninë, ka thënë guvernatori rajonal i Lvitit, Maksym Kozyskiy. Sipas tij, Rusia ka hedhur 30 raketa në bazën ushtarake në Javoriv.



Botërore”.

“Nëse më pyesni nëse Putini mund të përdorë armë kimike, mendoj se Putini mund të përdorë gjithçka tani, sidomos kur është në këtë pozitë të

vështirë. Politikisht ai e ka humbur këtë luftë, as në aspektin ushtarak ai nuk po e fiton atë”, ka thënë Duda.

I pyetur nëse përdorimi i armëve të tilla mund të nxisë intervenim të NATO-s, ai ka thënë: Natyrisht, secili shpreson që ai nuk do t'i përdorë ato. “Mirëpo... nëse ai përdor armë të shkatërrimit masiv, kjo do t'i ndryshonte rregullat e lojës. Natyrisht, (NATO) do të duhej të ulej në tavolinë dhe të mendonte seriozisht si të vepronte, sepse atëherë fillon që situata të bëhet e rrezikshme jo vetëm në Evropë, por në gjithë botën”, ka thënë Duda.

Eurodeputeti bullgar: Është koha që BE-ja t'i heqë vizat për Kosovën

PRISHTINË, 13 MARS - Anëtari i Parlamentit Evropian, Ilhan Kyuchyuk, ka thënë se është koha që Bashkimi Evropian t'i heq vizat për Kosovën si dhe të gjitha vendet anëtare të BE-së ta

njohin shtetësinë e Kosovës. Këto komente eurodeputeti bullgar Kyuchyuk i ka bërë pas takimit që pati me presidenten Vjosa Osmani dhe ministren e Jashtme,

Donika Gërvalla, në kuadër të Forumit Diplomatik në Antalia. "Është koha e fundit që BE t'i japë Kosovës liberalizimin e vizave dhe të gjitha vendet anëtare të BE-së ta njohin

vendin për të ecur përpara në integrimin e saj euroatlantik. Ky ishte mesazhi im për presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ministren e Jashtme,



Donika Gërvalla-Schwarz", ka shkruar Kyuchyuk në "Twitter".

Veteranët kërkojnë t'u rriten pensionet

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 MARS - Rritja e pagës minimale në vend që është paralajmëruar të ndodhë së shpejti, nuk do të ndodhë edhe për pagat e kategorive të luftës, në këtë rast për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se kur janë në pyetje kategoritë e luftës nuk duhet të bëhen pazare. "Nëse kjo qeveri mendon se duhet të anashkalohej kategoritë e luftës së UÇK-së, veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve, ku pa ta nuk do të ishin krijuar as institucionet, nuk do të kishim as parlament e as qeveri... Pra, kur janë në pyetje këto kategori të mos

të bëhen pazare e të mos bien në nivele të ulëta që, pa pëlqimin tonë, pa qenë pjesë e secilit ndryshim ligji për to, sepse për ne do të jetë e papranueshme dhe do të kundërshtohet", ka thënë ai.

Klinaku ka theksuar se kategoritë e dala nga lufta nuk janë të kënaqura me qasjen e kësaj qeverie ndaj tyre. Ai ka thënë se nëse nuk do të ketë ngritje të pensioneve edhe për këto kategori, atëherë nuk do të qëndrojnë duarkryq. "Ne nuk jemi të kënaqur me qasjen e kësaj qeverie që ua bënë kategorive të dala nga lufta, e nëse ndodh që të mos ketë ngritje të 'pensioneve', ne nuk do të qëndrojmë duarkryq, sepse veç jemi duke punuar në terren, dhe organet tona drejtuese do të vendosin për çdo kundërshtim", ka thënë Klinaku.



Sindikatat dalin kundër qeverisë, kërkojnë që paga minimale të jetë 400 euro

PRISHTINË, 13 MARS - Rashit Mehmeti, anëtar i kryesisë së Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), njëherësh anëtar i Këshillit Ekonomiko-Social dhe kryetar i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, kanë deklaruar se paga minimale duhet të jetë 400 euro e jo 264 euro sa propozon qeveria.

Mehmeti ka thënë se duke u bazuar në disa statistika që janë nxjerrë, del që paga 264 euro është tepër e vogël për qytetarët. "Ne i kemi nxjerrë disa statistika. Shporta e



konsumatorit, e cila nuk përfshinë as rrymën, as ujin e as mbeturinat, por vetëm jetën elementare, del diku 400 e diçka euro. Prandaj ne

konsiderojmë që është tepër e vogël 264 euro qysh e kanë nxjerrë në bazë të statistikave", ka thënë Mehmeti, duke shtuar se

nuk janë kundër qeverisë, mirëpo sindikata shikon gjithmonë anën e punëtorit. "Në radhë të parë ne nuk jemi kundër qeverisë. Mirëpo sindikata shikon gjithmonë anën e punëtorit, e shikon shportën e punëtorit, shportën e qytetarit gjithmonë. Unë mendoj që shporta e qytetarit tash për tash është dëmtuar mjaft shumë me këto ngritje të cilat janë bërë", ka thënë ai. Më tutje, Mehmeti ka rikujtuar se në vitin 2017 ka qenë një marrëveshje që

paga minimale të bëhet 250 euro, por që diçka e tillë s'është realizuar asnjëherë. Edhe kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, në një intervistë për "EO", ka thënë se paga minimale nuk duhet të jetë nën 400 euro. "Nuk do të pranojmë edhe në të ardhmen pagë minimale nën 400 euro pasi ne me këtë pagë që kemi kërkuar nuk është që do të kërkojmë që të bëjmë një jetë luksoze, por është diçka minimale pa të cilën nuk mund të kalohet", ka thënë Azemi.

Eksporti shënon rritje për 40 për qind, për dy muaj vlera arriti në 128 milionë euro

Prishtinë, 13 mars - Në dy muajt e parë të këtij viti, sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, 128 milionë euro mallra janë eksportuar nga Kosova drejt vendeve të tjera. Këtë e konfirmuar zëdhënësi i këtij institucioni, Adriatik Stavileci. Ai ka treguar se për muajt janar dhe shkurt të këtij viti, krahasuar me vitin e kaluar kur ishin eksportuar

96 milionë euro, është shënuar rritje për 40 për qind. "Në këta dy muaj kemi parë eksport prej 128 milionë eurosh që, në krahasim me 96 milionë të vitit të kaluar që kanë qenë për janar - shkurt, ka rritje rreth 40 për qind të mallrave të cilat janë duke u eksportuar nga Kosova drejt vendeve të tjera", ka thënë Stavileci për

"EO". Produktet të cilat importohen më së shumti, sipas Stavilecit, janë derivatet, industria e automjeteve dhe e duhanit. Stavileci ka sqaruar se trendi i mallrave të importuara ka mbetur i njëjtë, përveç që është vërejtur dallim në vlerë për shkak të rritjes së çmimeve.





Ish-ministri i Drejtësisë kërkon mbylljen e Gjykatës Speciale

Ish-ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se Kosova, në bashkëveprim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-në) dhe Bashkimin Evropian (BE-në), duhet t'i fillojnë konsultimet me kërkesën për procesin e përmbylljes së Gjykatës Speciale në Hagë. Ai ka theksuar se Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet të fillojnë së vepruari e t'i iniciojnë përpjekjet institucionale për ndryshimet ligjore të nevojshme me qëllim të përmbylljes së kësaj gjykate të fabrikuar në Moskë e Beograd

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 MARS - Ish-ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se Kosova, në bashkëveprim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-në) dhe Bashkimin Evropian (BE-në), duhet t'i fillojnë konsultimet me kërkesën për procesin e përmbylljes së Gjykatës Speciale

në Hagë. "Ledhatimi evropian në Këshillin e Evropës ndaj 'arushës ruse' në kurriz të së vërtetës sonë na e solli edhe 'narrativin' e kërkesës e mbrojtjes dhe dëshmimin e vlerave tona perëndimore si shoqëri e shtet në kërkim të 'drejtësisë' dhe 'ballafaqimit me të kaluarën' - 'pastrimin e luftës së drejtë e çlirimtare të UÇK-së nga elementet dyshuese për 'krime lufte'", ka shkruar Selimi

në llogarinë e vet në "Facebook", duke shtuar se e vërteta ishte dhe mbetet se duhej të plotësoheshin dëshirat dhe vullneti persekutues i Moskës dhe Beogradit që ishte adresuar kundër udhëheqësve të luftës sonë çlirimtare. "Ky çmim i 'drejtësisë ruse' e jo i vlerave perëndimore duhet paguar nga Kosova, e për fabrikim të dëshmime kompetencat do t'i bartnin Moska dhe Beogradi.

Këtë po e vërteton gjithnjë përmbyllja e akuzave në procesin gjyqësor të Hagës", ka thënë ai. Sipas tij, Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet të fillojnë së vepruari e t'i iniciojnë përpjekjet institucionale për ndryshimet ligjore të nevojshme me qëllim të përmbylljes së kësaj gjykate të fabrikuar në Moskë e Beograd. "Në këto rrethana të reja është e pafalshme që Kosova të heshtë për këtë padrejtësi historike. Kurthi dhe kompromisi mashtrues shumëpalësh me drejtësinë e agjendën e Putinit, në kurriz të së vërtetës sonë për luftën e udhëheqësit e UÇK-së në Gjykatën Speciale, duhet të marrë fund. Pas shpërfytyrimit agresiv e vrasar të Putinit e Rusisë në Ukrainë, miqtë ndërkombëtarë e kanë më të

lehtë ta kuptojnë dhe ta pranojnë mashtrimin, të vërtetën dhe çmimin e padrejtësisë që Kosova sot po e paguan për llogari të 'drejtësisë dhe barazisë', të kërkuar pikërisht nga Beogradi dhe Moskë e Putinit", ka deklaruar Selimi.

Ai ka theksuar se lufta në Ukrainë ka kthyer parimet e Nurembergut. "Kjo luftë ka përmbytur konceptet e krimeve eventuale që identifikon fituesin dhe humbësit. Atëherë kur cenohen vlerat progresive e të demokracisë, legjitimiteti vjen mbi legalitetin. Në fund të fundit, edhe intervenimi i NATO-s në Kosovë u bazua mbi legjitimitetin e jo mbi legalitetin", ka deklaruar ish-ministri i Drejtësisë, Selim Selimi.

Dy vjet nga raportimi i rasteve të para me Covid në Kosovë

**EPOKA
ERE** **F. DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 MARS - "Dy vjet më parë u raportuan rastet e para me Covid-19 edhe në vendin tonë!", ka njoftuar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, ekipet e IKShPK-së po punojnë pandërprerë deri në përfundimin final të pandemisë. "Të gjithë pa dallim dhe domosdoshmërisht duhet

t'i vazhdojmë të zbatojmë masat parandaluese kundër Covid-19 dhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë!". "Prandaj, në vazhdimësi vlen për secilin person dhe më tej vazhdojmë të bëjmë thirrje: Mbulo gojën dhe hundën me maskë! Mbjaj higjienën! Respekto distancën! Vaksinohu!", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të dielën, nga 1 217 testime, 32 qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar dy raste të vdekjes. Të dielën janë shëruar 69 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 042. Në total numri i rasteve aktive është 709. Në 24 orët e fundit janë dhënë 148 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 817 696 doza të

vaksinës. Deri më sot 818 331 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 630 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Në pesë spitale të përgjithshme në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës nuk ka të shtrirë asnjë pacinet për trajtim spitalor nga Covid-19. Spitali i Prizrenit, i Mitrovicës, i Gjakovës, i Ferizajt dhe i

Vushtrisë në raportet e datës 13 mars 2022 kanë raportuar se nuk kanë pacientë me Covid-19. Ndërkaq, në Spitalin e Gjilanit dhe atë Pejës janë vetëm 3 pacientë me Covid-19. Në Klinikën Infektive në trajtim janë 11 pacientë, prej tyre 4 të konfirmuar me Covid-19 pozitivë. Me oksigjeno-terapi në tërë ShSKUK-në po trajtohen 11 pacientë, kurse në Mjekim Intensiv janë të shtrirë 3 pacientë.

Krasniqi takon në Hagë Thaçin dhe Veselin: Të fortë dhe krenarë për lirinë e Kosovës

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka sjellë të fala të përzemërta nga Haga, pas vizitës që u ka bërë dy ish-liderëve të PDK-së, Hashim Thaçit e Kadri Veselit. Krasniqi ka bërë të me dije nëpërmjet llogarisë në "Facebook" se i ka vizituar Thaçin dhe Veselin, ndërsa

vizitën e tij në Hagë e ka cilësuar tejet emocionale. Kreu i PDK-së shkruan se duke besuar në drejtësi dhe në luftën e pastër e mbrojtëse të popullit të Kosovës, pret kthimin e tyre triumfues sa më parë. "Të fortë dhe krenarë për rrugëtimin e tyre për lirinë e Kosovës, ashtu si përherë, i pashë dy liderët historikë të Kosovës dhe të PDK-së, Hashim Thaçin e Kadri



Veselin, gjatë një vizite tejet emocionale që pata në Hagë. Ashtu siç besojmë në drejtësi, të gjithë besojmë se ata, bashkë

me shokët e tyre çlirimtarë, po mbahen padrejtësisht atje, sepse lufta mbrojtëse e popullit të Kosovës ishte e drejtë dhe e

pastër, andaj edhe e presim kthimin e tyre triumfues sa më parë. Të fala të përzemërta!", ka thënë Krasniqi.

Kurti: Vetëm një botë e bashkuar demokratike do ta ndalojë Putinin



PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Në Forumin për Diplomaci në Antalia të Turqisë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në panel diskutimi, si dhe zhvilloi disa takime bilaterale. "Ndryshimi politik ka nevojë për një lëvizje: një kauzë, një organizatë dhe një përpjekje", ka deklaruar kryeministri Kurti në panelin e diskutimit me liderë, me temën "Përfaqësimi i ndryshimit".

Kurti ka treguar se bashkë me kryeministrin e Bullgarisë, Kiril Petkov, presidentin e Guinea Bisaut, Umaro Sissoco Embalo dhe sekretaren e përgjithshme të Këshillit të Evropës, Marija Pejčinović Buriq, në këtë panel u bisedua mbi rininë, drejtësinë dhe punësimin. Për invazionin rus në Ukrainë dhe implikimet e sigurisë për të gjithë Evropën u bisedua në takimin ndërmjet kryeministrit

Kurti dhe zëvendëskryeministrit të Letonisë, Artis Pabriks. Kryeministri Kurti e falënderoi për kontributin e Letonisë në KFOR dhe mbështetjen për agjendën e integrimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Ndërsa në takimet me ministrin e Punëve të Jashtme të Austrisë, Alexander Schallenberg, përfaqësuesin e Lartë për

Bosnjë Hercegovinë, Christian Schmidt dhe zëvendëskryeministrin e Malit të Zi, Dritan Abazović, kryeministri Kurti theksoi se nuk duhet t'u dorëzohemi autokratëve askund asnjëherë. "Vetëm një botë e bashkuar, demokratike aktive do ta ndalojë Putinin dhe do të parandalojë despotë të tjerë në të ardhmen", theksoi ai. Në takimin me përfaqësuesin

special të Bashkimit Evropian për Dialogun Kosovë-Serbi dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčak, kryeministri Kurti theksoi se sanksionet kundër Rusisë janë minimumi që mund të bëjmë. Kryeministri ka kërkuar më shumë vëmendje për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe që të mos injorohet lufta hibride në rajonin tonë.

Inflacioni në Kosovë, 7.5 për qind

PRISHTINË, 13 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se norma vjetore e inflacionit e matur në muajin shkurt 2022 me muajin shkurt 2021 ishte 7.5 për qind. Sipas ASK-së, rritje të çmimeve kanë pasur buka dhe drithërat, qumështi, djathi, vezët, vajrat dhe yndyrat ushqimore. Rritje të çmimeve kanë shënuar edhe pemët dhe perimet dhe shumë prodhime të tjera. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit, sipas ASK-së, është më i lartë prej 1.1-përqindësh në muajin shkurt 2022 krahasuar me muajin janar 2022.

Çmimet janë në trend të rritjes për shkak të krizës në tregje që ka shkaktuar pushtimi rus i Ukrainës.

Lufta në Ukrainë ka rritur në veçanti çmimet e energjisë, naftës dhe gazit.

Çmimet e konsumit kanë shënuar rritje edhe gjatë muajit mars.

Të enjten, më 10 mars, çmimi për një litër vaj nga 2.19 euro është rritur në 3.49 euro. Kjo rritje e çmimit u konsiderua rritje artificiale dhe keqpërdorim nga ana e tregtarëve.

Inspektorati i Tregut në Kosovë më 10 mars mbylli përkohësisht

dy depo të operatorëve ekonomikë në Fushë-Kosovë dhe Graçanicë.

Kjo mbyllje ndodhi pasi Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë njoftoi tregtarët se po bëjnë veprime mashtruese ndaj konsumatorit.

Sipas ministrisë, disa operatorë kanë zbratur më 9 mars raftet e vajit ushqimor në pikat e shitjes me pakicë, duke krijuar përshtypjen se ka mungesë të produktit. Kurse më 10 mars kanë rikthyer këtë produkt me çmim 3,49 euro për litër.

Kosova është përballur me rritje çmimesh edhe para shpërthimit



të luftës në Ukrainë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Sipas Agjencisë së

Statistikave të Kosovës, inflacioni në janar të këtij viti ishte në 7.1 për qind, krahasuar me 0.2 për qind sa ka qenë në janar të vitit 2021.

BQK-ja: Ekonomia e Kosovës ndien krizën me rritjen e çmimeve

PRISHTINË, 13 MARS - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka vlerësuar se ekonomia e Kosovës pritet të ndiejë krizën përmes kanalit të rritjes së çmimeve si rrjedhojë e luftës në Ukrainë. Ditë më parë zyrtarë të Trustit kanë konfirmuar se kriza në tregjet e ndërkombëtare ka bërë që të bie vlera e investimit në kthim rreth 90 milionë euro. Ndërsa tash, përveç rritjes së inflacionit, BQK-ja të rrezikuar është duke e parë edhe Trustin, i cili ka investuar rreth 80 për qind në tregjet ndërkombëtare. "Duke pasur parasysh faktin se ekonomia e Kosovës ka volum të lartë të importeve nga vendet e BE-së dhe se lufta ndërmjet Ukrainës dhe Federatës Ruse do të ndikojë, sidomos në sektorin e energjisë, presim që edhe ekonomia e Kosovës të ndikohet përmes kanalit të çmimeve. Gjithashtu, zhvillimet e tilla ndikojnë edhe në tregjet e kapitalit, rrjedhimisht në performancën e aseteve të Trustit, por këto janë efekte të natyrës më afatshkurtër si rezultat i luhatjeve të tregjeve dhe në periudha afatmesme pritet të rikuperohen", ka thënë për "Kosovapress" zëdhënësi i BQK-së, Kushtrim Ahmeti.

Pavarësisht prej kësaj, Ahmeti ka thënë se qytetarët nuk kanë pse të ndihen të brengosur për depozitat e tyre në bankat komerciale në Kosovë për shkak të luftës në Ukrainë pasi, sipas tij, bankat nuk kanë ekspozim ndaj tregjeve të Evropës Lindore dhe niveli i transaksioneve është i ulët. "Segmentet e tjera të ekonomisë së vendit nuk kanë ekspozim ndaj tregjeve të Evropës Lindore dhe niveli i transaksioneve është relativisht i ulët. Rrjedhimisht, për vitin 2022 presim kontribut të lartë të sistemit bankar vendor në zhvillim të mëtejshëm të ekonomisë vendore dhe financim të aktivitetit ekonomik në përgjithësi", ka thënë ai.

Për shkak të luftës në Ukrainë, ish-ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, ka thënë se, përveç rritjes së çmimeve, ka mungesë të mallrave esenciale siç janë gruri, mielli, vaji dhe sheqeri. "Po përballemi me një valë të re të inflacionit, e cila ka shumë gjasa që të mos jetë vetëm inflacion, por në ditët e ardhshme të përballemi edhe me mungesë të produkteve. Kjo besoj se do të jetë më problematike dhe do të jetë shqetësim tejet i madh për



mirëfunksionimin komplet të industrisë, por edhe të institucioneve shtetërore. Janë dy rrafshë në të cilat duhet të veprojnë qeveria, e cila, fatkeqësisht, është duke qëndruar si spektatore, nuk e

kemi parë veprime konkrete", ka thënë Bajrami, duke kërkuar nga qeveria furnizim me artikuj kryesor nga vendet mike të Kosovës.

Ndërsa profesori në Fakultetin Ekonomik, Nagip Skënderi, ka

thënë se në këtë kohë krize qeveria duhet urgjentisht ta bëjë rishikimin e buxhetit 2022 në mënyrë që të miratohet një pako ekonomike për mbështetjen e qytetarëve dhe ekonomisë në vend.

Vuçiqi: Duan ta anëtarësojnë Kosovën në NATO



PRISHTINË, 13 MARS - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar sonte se disa në Perëndim dëshirojnë që katër vendet e BE-së, anëtare të NATO-s, ta njohin Kosovën, në mënyrë që Kosova të anëtarësohet në NATO, e këtë e ka konfirmuar edhe ish-zëdhënësi i NATO-s, Jamie Shea. Vuçiqi ka deklaruar kështu në televizionin "Pink" kur është pyetur se si e komenton faktin se Jamie Shea ka thënë se nevojitet që vetëm edhe katër vende të NATO-s të pajtohen

dhe Kosova të anëtarësohet në Aleancën Veri-Atlantike.

Vuçiqi tha se këto katër shtete janë Rumania, Sllovakia, Spanja dhe Greqia, por se nuk mendon se kjo është diçka reale për momentin. "Kjo është ideja e tyre. Ata duan ta shtyjnë atë ide, por nuk mendoj se është reale tani. Ata nuk kanë nevojë për Serbinë si kundërshtar, sepse nuk kanë nevojë për ndonjë problem tjetër diku. Por, kjo ide ekziston. Nuk e kam shpikur unë historinë e NATO-s dhe Kosovës - 50 herë i kam kaluar të

gjitha letrat që i marr nga shërbimet", ka thënë Vuçiqi.

Ai ka shtuar se, "megjithatë, ata nuk e kuptojnë se amerikanët nuk janë krejtësisht për këtë, as evropianët nuk mund të jenë për këtë, sepse ata e perceptojnë NATO-n si një aleancë të mbrojtjes dhe sigurisë dhe jo si diçka për presion politik. Nuk jam i sigurt se do ta marrin atë vendim", ka shtuar Vuçiqi dhe ka theksuar se Shea ka treguar edhe në të kaluarën se çfarë mendon dhe dëshiron për Serbinë.

KULTURA E DIALOGUT DHE E ARDHMJA E KOSOVËS



Milazim KRASNIQI

Problemet e mëdha të Kosovës janë të natyrës kombëtare, si konflikt ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve për pronësi mbi territorin dhe të natyrës gjeopolitike, si rivalitet ndërmjet Perëndimit dhe Rosisë, për prezencë e dominim më këto hapësira. Përplasja e ideologjive kombëtare, shqiptare e serbe, ushqehet nga dy burime të ndryshme, që edhe e kanë prodhuar fizionominë e ndryshme të tyre: ideologjia kombëtare serbe ushqehet nga mitologjia, në qendër të së cilës është Beteja e Kosovës, ndërsa ajo shqiptare ushqehet nga historia që ka ndodhur me të vërtetë, me Lidhjen e Prizrenit si themeli mbi të cilin është ngjizur kombformimi shqiptar. Meqë as mitit e as historisë nuk i shpëtojnë lehtë e shpejt energjitë, është e pritshme që ky konflikt do të jetë aktiv dhe agresiv edhe për një kohë të gjatë. Kriza e tejzgajtur në veriun e Kosovës dhe kriza e rikthyer në Luginën e Preshevës, janë dëshmi e këtyre potencialeve shpërthyes. Pa prezencën dhe pa presionin ndërkombëtar, kjo do të mund të eskalonte në konflikt të armatosur. Edhe nëse konflikti i armatosur shmanget, konflikti do të mbetet i zjarrtë dhe i hapur në fushat politike, në festat kishtarë ortodokse, në debatet historiografike, në krijimtarinë artistike dhe në diskursin publicistik. Këto janë të mjaftueshme për ta mbajtur të ndezur zjarrin e konfliktit.

Problemet ndërfetare nuk kanë qenë asnjëherë në plan të parë

Përplasja e dytë e madhe në Kosovë është ajo ndërmjet Perëndimit dhe Rosisë, veçmas nga koha kur vendi i mbetur bosh i Perandorisë Osmane, duhej të zihej ose nga sllavët e sponsorizuar nga Rusia, ose nga shqiptarët e sponsorizuar nga

Austro-Hungaria. Edhe në vitin 1999 ka qenë e njëjta skemë, vetëm me ndryshimin që në vend të Austro-Hungarisë, lidere e Perëndimit ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto dy përplasje të mëdha, njëra kombëtare e tjetra ndërkombëtare, kanë eklipsuar problemet e tjera, si problemet fetare e kulturore, meqë dy përplasjet e mëdha as sot nuk janë zgjidhur përfundimisht.

Rrjedhimisht, problemet ndërfetare e ndërkulturore, nuk kanë qenë asnjëherë në plan të parë dhe nuk kanë pasur energji për të prodhuar kriza, por as për t'i zgjidhur krizat ekzistuese. E vërteta është që në kuadër të ideologjisë serbe për sundimin e Kosovës, ka qenë e inkorporuar ideja për dëbimin e shqiptarëve me etiketën e diskriminimit fetar. Poashtu edhe në Planin Ahtisari janë inkorporuar zgjidhje që i japin statusit të Kishës Ortodokse Serbe dimension problematik për një shtet laik. Por, ky ka qenë dhe është instrumentalizim i Kishës Ortodokse Serbe, në kuadër të qëllimeve hegemoniste kombëtare serbe. Ndërsa, konteste kulturore në Kosovë praktikisht nuk ka pasur për arsye se të gjithë popujt që kanë jetuar e jetojnë në Kosovë, po edhe në Ballkan, përfshirë edhe vetë Perandorinë Osmane përkatesisht Turqinë e sotme, karakterizohen nga eklektizimi kulturor, ku dhënia e marrja mes kulturave ka qenë intensive, sa që nganjëherë është dukur se po krijohej një simbiozë kulturore ballkanike. Fjala vjen, këngët akritike bizantine, këngët kreshnike shqiptare dhe këngët heroike sllave, me elemente ngjashmërisht që kanë, janë shembull i këtij eklektizmi kulturor, sikundër që janë të tilla edhe këngët e mëvonshme, si ajo që e pati hulumtuar Adela Peva, me dokumentarin e saj të famshëm, "E kujt është kjo këngë?" Prandaj, as sot nuk mund të pritët që dialogu ndërfetar dhe ai ndërkulturore të kontribuojnë në mënyrë vendimtare për zgjidhjen e konfliktit kombëtar shqiptar-serb dhe as të zbutjes së rivaliteteve gjeopolitike mes Perëndimit (ku inkuadrohet edhe Turqia) dhe Rosisë, sepse as besimet fetare e as kulturat nuk i kanë krijuar këto probleme. Megjithatë, kontributet e dialogut ndërfetar e ndërkulturore

mund të japin një ndihmesë, së paku për tejkalimin e disa paragjyqimeve dhe për relaksimimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Multietniciteti si kornizë

Për ta ditur se çfarë mundësisht ka dialogu ndërfetar e ndërkulturore në Kosovë, fillimisht duhet të dimë se cili është statusi i besimeve fetare në Kosovën e pavarur dhe cila është gjendja e kulturës në këtë vend. E para, liritë fetare në Kosovën e pavarur janë të përcaktuara nga multietniciteti si kornizë e afirmimit të identiteteve etnike dhe fetare, nga traditat tolerante fetare të banorëve dhe nga synimi që të adaptohen standardet europiane edhe në punë të respektimit të lirive dhe të drejtave fetare. Në këtë kuadër, zgjidhja që ka pranuar Kosova e pavarur për statusin e kishave dhe të manastireve serbe dhe përgjithësisht për Kishën Ortodokse Serbe, është një zgjidhje maksimaliste e respektimit të kërkesave të një komuniteti fetar. Kjo zgjidhje maksimaliste edhe ka krijuar disproporcion ndërmjet bashkësive fetare në vend, që faktikisht e demotivojnë Kishën Ortodokse Serbe, përtaqë përket dialogut ndërfetar. Ajo është tërësisht e mobilizuar që ta minojë sa të jetë e mundshme shtetin e Kosovës, që do të thotë se ajo injoron projektet e dialogimit. Megjithatë, është mirë që Bashkësia Islame e Kosovës dhe Ipeshkvia e Kosovës, (të cilat kanë komunikim të mirë mes vete) i kanë të hapura vazhdimisht ofertat për bashkëpunim edhe me Kishën Ortodokse Serbe. Por, statuset disproporcionale të bashkësive fetare në vendin tonë, e veçmas statusi i Kishës Ortodokse Serbe, vërtet paraqesin vështirësi serioze në promovimin e dialogut ndërfetar. Këtë duket se nuk e ka pasur para sysh Ahtisari dhe ata që e kanë pranuar Planin e tij, por në realitet ai plan e ka stimuluar dezintegrimin e jo integrimin. Këto staturat të pabarabarta demotivojnë dialogun permanent, krijimin e një agjende të përbashkët përballë shtetit dhe të kontributeve për zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë e të vendit. Por, fija e përbashkët e tyre, për dialog ekziston, për arsye

se feja e krishterë dhe ajo islame, si fe abrahamike, në esencë janë universale, dhe mbi këtë premisë ato mund të dialogojnë dhe të afirmojnë vlerat universale të paqes e të mirëkuptimit ndërmjet njerëzve e popujve.

Në këtë kontekst, universaliteti pohon se njerëzit janë të lirë në zgjedhjen që bëjnë, ndërsa përgjegjësinë për zgjedhjen që kanë bërë e japin vetëm para Krijuesit të vet, e jo para njëritjetrit. Kjo ua heqë gjithë legjitimitetin hierarkive fetare e kujtdo tjetër që të gjykojnë të tjerët në emër të zgjedhjes që kanë bërë, sepse gjykimi është vetëm në kompetencë të Krijuesit. Të shkarkuar nga ky imponim, besimtarët e besimeve të ndryshme, mund të dialogojnë pa ngarkesa e pa komplekse dhe kjo mundëson njohjen më të mirë të përvojave të tyre dhe afrimin e tyre. Pra, ky model dialogimi, i bazuar në praktikën e "pluralizmit religjioz" (Hofman) që ekziston në jetën reale, do të duhej të promovohet në vendin tonë. Në atë rast jam i bindur se dialogu ndërfetar do të ndihmonte shumë në tejkalimin e problemeve të shoqërisë sonë, në rend të parë në eliminimin e pasojave të çmoralizimit të shoqërisë, që ka ardhur si pasojë e sundimit të gjatë komuno-ateist.

Dy anët e medaljes

Dialogu ndërfetar i ka dy anë, si një medalje. Ata që kanë vullnet të mirë, zgjedhin anën që afron, që prodhon respekt e mirëkuptim. Kjo është ana e vërtetë e një besimi fetar të mirëfilltë, të bazuar në udhëzimet dhe urdhëresat e Zotit. Ndërsa, ata që kanë energji negative, që duan ta keqpërdorin fenë për qëllime politike ose qëllime të tjera, theksojnë ndasitë, diferencat, dhe ato i zmadhojnë e i deformojnë, në mënyrë që të provokojnë intolerancë dhe ekstremizëm. Unë uroj që në vendin tonë po edhe në gjithë botën, të përdoret ana e mirë e interpretimit të besimeve fetare, ajo anë që prodhon njohje, respekt, mirëkuptim e bashkëjetesë paqësore. E dyta, sa i përket dialogut ndërkulturore, ai në Kosovë duhet të zhvillohet para së gjithash lidhur me trashëgiminë kulturore, sepse kjo trashëgimi në shumë raste është e përbashkët.

Çështja e trashëgimisë kulturore të Kosovës do të duhej të trajtohej vetëm si problem kulturor dhe të rregullohej me ligje, që do të jenë të njëjtave standarde me shtetet e sotme demokratike europiane. Europeanizimi i kësaj problematike e jo riafirmimi i ballkanizimit të saj, paraqet themelin e zgjidhjes së kësaj çështjeje të ndieshme. Mirëpo, ky standard nuk është i arritur lehtësisht, sepse provizionet e Planit të Ahtisarit e kanë parcelizuar trashëgiminë kulturore, duke e minimizuar mundësinë e integritimit në një kulturë të përbashkët identifikuese të vlerave të këtij vendi. Megjithatë, dialogu ndërkulturore do të mund të ndihmonte në njëfarë mase edhe në ndriçimin e të kaluarës historike. Në këtë aspekt ata që mendojnë se Ballkani prodhon histori më shumë se sa që mund të konsumojë, duhet ta kenë para sysh se kjo ka të bëjë me falsifikimin e historisë e jo me të vërtetat e saj. Ky dimension i problemit duhet të zgjidhet me rishikimin dhe rishkrimin e saj, duke u bazuar në fakte dhe vlera të vërteta, dhe duke e parë historinë e gadishullit dhe të këtyre kombeve në kontekstin e historisë evropiane. Këtu janë hapësirat më të mëdha të dialogut ndërkulturore edhe në vendin tonë. Pa e mundur kompleksin e madhësisë së rreme ballkanike, është vështirë të evitohen konfliktet edhe në të ardhmen, e ku trashëgimia kulturore dhe fetare do të përdoret për mobilizimin e vazhdueshëm mbi projeksione nacionaliste. Në të kaluarën tonë, kultura ka ndikuar fare pak mbi politikën, ndërsa politika ia ka zënë frymën kulturës. Edhe për këtë arsye ka pasur më shumë luftëra se sa paqe, më shumë mosmarrëveshje se sa marrëveshje. Fatkeqësisht, ende nuk jemi shkëputur plotësisht prej kësaj centrifuge shkatërimtare. Me këto elita fetare, kulturore e politike që kemi, jo vetëm në Kosovë, po edhe në Serbi, në Maqedoni e në Shqipëri, besoj se vonesa e shkëputjes nga centrifuga e konfliktit, do të jetë më e gjatë. Përveç në rast se katalizatori potencial, i mishëruar në autoritetin e Bashkimit Europian, arrinë t'ua imponojë një agjendë më integruese e të pakthyeshme

A do ta rritin prodhimin subvencionet?



PRISHTINË, 13 MARS - Fermerit Zenë Haradinaj i duhen rreth 3 900 euro për blerjen e plehut artificial për t'i plehëruar 13 hektarë tokë të kultivuar me grurë, pa përfshirë shpenzimet për derivate të naftës dhe punëtorë.

Dy punëtorë që i nevojiten paguhen nga 25 euro në ditë, ndërsa shpenzimet për naftën thotë se i llogarit pas përfundimit të procesit të plehërimit.

Për një hektar tokë të kultivuar nevojiten deri në 300 kilogramë pleh. Haradinajt, me 13 hektarë, i nevojiten 3 900 kilogramë pleh. Çmimi për një kilogram është një euro.

Sipërfaqen e kultivuar me grurë, Haradinaj e ka në fshatin Stanovc, komuna e Vushtrisë, e cila ndodhet në verilindje të Kosovës.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Haradinaj thotë se pret subvencione nga institucionet shtetërore, që do ta ulnin vlerën e shpenzimeve të tij. Ai thotë se shumica që i duhet për blerje të plehut, punëtorë dhe naftë, është e papërbalueshme për të.

Qeveria e Kosovës, më 9 mars, ka ndarë 50 milionë euro për subvencionimin e sektorit të bujqësisë. Vetëm për subvencionimin e grurit janë ndarë 474 euro për

hektarë, përfshirë këtu shpenzimet e plehut dhe të naftës.

Deri më tash subvencionet kanë qenë 75 euro për hektarë.

Vendimi i ri është marrë në kohën kur shumë vende kanë ndaluar eksportet e drithit për shkak të krizës në tregje dhe rritjes së çmimeve që ka shkaktuar lufta në Ukrainë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se subvencionet janë ndarë me qëllim të rritjes së rendimenteve, që do t'i plotësonin nevojat për konsum dhe do t'i zvogëlonin nevojat për import të lartë.

Gruri është lënda e parë për prodhimin e miellit dhe, si i tillë, konsiderohet prodhim strategjik për sigurinë kombëtare.

Për sigurimin e tij Kosova është e varur nga importi.

Në vitin 2021 nga fermerët e Kosovës janë prodhuar 280 mijë tonë grurë. Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës për atë vit, 115 mijë tonë lloje të grurit dhe miellit janë importuar nga shtete të ndryshme të Evropës.

Nevojat e popullatës së Kosovës janë për rreth 400 mijë tonë grurë në vit.

Haradinaj thotë se çmimet e prodhimeve të nevojshme për kultivim të grurit janë rritur, disa prej tyre edhe janë trefishuar. "Vetëm të filloj nga

plehu: vitin e kaluar 25 kilogramë pleh kanë kushtuar tetë euro, gjatë këtij viti kushtojnë 25 euro; nafta ka qenë pak mbi 1.10 euro, tashmë mbi 1.60 euro. Nuk e di sa mjaftojnë paratë e ndara [nga qeveria]. Ta shohim sa shpenzojmë naftë dhe pleh", thotë Haradinaj.

Milot Gashi nga kompania "Agrimatco Kosovo L.L.C" në Prishtinë, e cila merret me shitjen e lëndëve të para për bujqësi, konfirmon për Radion Evropa e Lirë rritjen e çmimit të plehut artificial. Ai thotë se 100 kilogramë pleh artificial tani kushtojnë 100 euro krahasuar me vitin e kaluar kur kanë kushtuar 32 euro.

Plehërimi i grurit bëhet në fillim të muajit mars, ndërsa riplehërimi në muajin prill. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2020 sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka qenë mbi 421 mijë hektarë. Prej tyre, mbi 80 mijë hektarë kanë qenë të kultivuar me grurë.

Tahiri: Subvencionimi do ta rritë sipërfaqen e tokës së punueshme

Kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës, Tahir Tahiri, konsideron se shumica

subvencioneve për bujqësinë është e mjaftueshme. Sipas tij, ajo do të rritë interesimin e bujqve për t'i punuar tokat pasi, siç thotë, gati 50 për qind e tokave bujqësore kanë mbetur djerrinë për shkak të përfitimeve të ulëta që kanë pasur fermerët. "Kjo është një ndihmë shumë e madhe, prandaj mbetet që bujqit të angazhohen dhe ta punojnë tokën. Mendoj se ata fermerë që kanë kushte për punë do të dalin me përfitime", thotë Tahiri për Radion Evropa e Lirë.

Përveç për grurin, Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete edhe për subvencionimin e misrit, fasules dhe patates me 100 euro për hektarë.

Kriteret, ende të paqarta

Kryeministri Kurti ka thënë se aplikimet për subvencionim do të nisin gjatë këtij muaji. Kriteret për aplikim nuk janë ende të qarta.

Zenë Haradinaj thotë se beson që ato do të jenë të njëjta sikur në vitet e kaluara. "Shumë, shumë letra nevojiten. Unë pjesën më të madhe të tokës nuk e kam në emrin tim. Një pjesë e kam me qira. Vetëm për pesë hektarë kam për të aplikuar, por nuk i di kriteret", thotë ai. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Kosovës nuk i është

përgjigjur pyetjes së REL-it për kriteret që duhen plotësuar për të përfituar nga subvencionet.

Vitin e kaluar personat që kanë aplikuar është dashur ta dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit, dëshmi për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, dëshmi nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme, kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira dhe dokumente të tjera.

Për të përfituar 75 euro, fermeri është dashur të ketë më së paku dy hektarë tokë të mbjellë me kulturë të grurit. Më herët fondet e ndara për subvencionim në disa raste edhe janë keqmenaxhuar.

Zyra Kombëtare e Auditorit, në auditimin e bërë për vitin 2019, ka nxjerrë në pah mosplotësimin e disa kriterëve të kërkuara nga përfituesit e subvencioneve.

Për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrjes së rryshfetit vitin e kaluar janë arrestuar 32 persona, përfshirë zyrtarë me pozita të ndryshme në Agjencinë Zhvillimore të Bujqësisë dhe Agjencinë e Pyjeve të Kosovës. Të dyja këto agjenci funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

FJALIM NË MUZEUN KOSOVA NË VLORË, ME RASTIN E PROMOVIMIT
TË LIBRIT TË BEDRI ISLAMIT " TRIADA E KOSOVËS"!

MUZEU I KOSOVËS NË VLORË NGJARJE KOMBËTARE

**Vizite ne Sheshin e Flamurit dhe ne varrin e Ismail Qemalit
Personalitetet me te larta te ardhura nga Maqedonia e Veriut
dhe Kosova, shoqeruar nga Bujar Leskaj**



LAJME

PERSONALITET MË TË LARTA TË ARDHURA NGA MAQEDONIA E VERIUT DHE KOSOVA, SHOQËRUAR NGA BUJAR LESKAJ

VIZITË NË SHESHIN E FLAMURIT DHE PRANË VARRIT TË ISMAIL QEMALIT

Vlora Televizion

<https://epus.tvlora.ai/>E-mail: epus@vloratv@gmail.com

facebook.com/epus.tvlora

Ismet SYLEJMANI

I nderuar deputeti i Vlorës, miku ynë Bujar Leskaj, I dashur Baca Bedri Islami, ish-Kryetari historik i Lëvizjes Popullore të Kosovës në kohën e luftës së UÇK-së, I dashur Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, I dashur udhëheqësi i madh i vitit 1981 Hydajet Hyseni, I dashur babai i Heroit të Kombit Labinot Krasniqi, Gani Krasniqi, Të dashur vëllezër të heronjëve të kombit Fehmi Lladrovci e Afrim Zhitia, Ramiz Lladrovci e Naim Zhitia, I nderuari ish-Kryetari i Parlamentit të Shqipërisë, të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut Artan Grubi, I nderuar Kryetar i Kërçovës Fatmir Dehari, Të nderuar deputet të parlamentit të Shqipërisë, të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut e të Parlamentit të Kosovës, të nderuar shkrimtarë, artist e krijues të ndryshëm, Të nderuar të pranishëm, Zonja dhe zotrinjë, I dashur popull i Vlorës heroike dhe i gjithë Shqipërisë!

Kemi ardhur sot në Vlorë, të ftuar në këtë eveniment të madh nga Bujar Leskaj e nga Bedri Islami, të cilët sot nga vendi i shenjtë i globit shqiptar, paralajmërojnë se ashtu si edhe në të kaluarën, Vlora vazhdon të mbetet pikënisja e madhe e furnizimit të historisë më të vërteta reale dhe nga ato të mëdhatë, që e bëjnë kombin tonë të nderuar e të respektuar në shekuj! Jemi të nderuar që sot, që në mesin tonë e kemi njërin prej Udhëheqësve të mëdhenj të popullit shqiptar, shokun e bashkëveprimtarin e Heronjëve të Kombit Fehmi Lladrovci e Afrim Zhitia, themeluesin e Tri Ushtrive Çlirimtare, burrin e madh të kombit e figurën e shquar të historisë, që ka lindur në Zajaz të Maqedonisë, një pjesë të jetës së tij e ka kaluar në Kosovë dhe disa centimetra të gjatësisë së tij trupore, ndonëse është i shkurtë me shtat, i ka arritur në Gllanasellë të Drenicës, te shtëpia e Axhës Tush Lladrovci, bashkë me Fehmiun, të cilët më vonë në Gjermani, do ta bënin vëlla të tyre, djalin e personazheve të Lulit të Vocërr e të Zenelit të Migjenit, Bedri Islamit, i cili

udhëhoqi me sukses të madh LPK-në, atëherë kur Kosova heroike luftonte me Serbinë pushtuese, dhe e vulosi dashurinë e tij epike për Kosovën dhe sikur Ali Ahmeti edhe shkodrani Bedri Islami u bë biri i madh e besnik i sajë! Është knaqësia ime që të mbajë këtë fjalë rasti në promovimin e librit "Triada e Kosovës", të autorit Bedri Islami, të këtij shqiptari të madh e të lavdishëm, shkodrani nga Drenica, shokut e bashkëveprimtarit të Heroit të Kombit, Gjeneralit të pavdekshëm Fehmi Lladrovci e të Gjeneralit të pamposhtur Ali Ahmeti! Autori i librit "Triada e Kosovës", Bedri Islami, padyshim se është figurë e madhe integruese, te i cili shohim një histori të tërë, sepse rrethrotullimi i biografisë së Tij, të mban të lidhur fortë për popullin, për Atdheun e për Kombin! Bedri Islami librin e Tij "Triada e Kosovës" e bën libër të veçantë dhe të dalluar nga të gjithë të tjerët, sepse në të e ka të botuar letrën e fundit të Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari!

Të dashur vëllezër e motra, Në Vlorë në këtë qytet të

e të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

Dy pavione të cilët do të kenë nga tri shkronja të njejtë UÇK, e që perfaqësojnë luftërat e dy ushtrive, të cilat luftuan dhe fituan luftën me ndihmën e NATO-s në ballë me top aleatin e kombit tonë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Të rrallë janë popujt e lëre më qytetet, që do të kenë një muze me dy pavione të dy ushtrive, të cilat u themeluan nga bijtë më të mirë dhe u udhëhoqen me guxim e trimëri të rrallë, aq sa jehona e luftërave të tyre kaloi kufinj të Atdheut dhe përfshiu tërë planetin!

Shpresojmë se pas Muzeut të Kosovës, në Vlorë do të vjen edhe Fehmiu e Xheva, dhe si sot do të vijmë në inaugurim të shtatit të derdhur në bronz të qiftit titanik, të cilët do ti bëjnë roje nderi përgjithmonë qytetit lavdimadh të Pavarësisë së Shqipërisë!

I dashur dhe shumë i nderuar miku ynë i madh Bujar Leskaj, faleminderit zotit që Ti ekziston, të duam shumë e të urojmë suksese të mëdha në detyrën Tënde fisnike të nderimit të Kosovës me Muze të Sajë dhe të vendosjes së shtatores së Fehmi e Xheva Lladrovci këtu në Vlorë!

Gjithashtu shpresojmë se shkrimtari i madh Bedri Islami deri atëhere do të na dhurojë libra të rinjë, kurse Udhëheqësi e biri besnik i popullit, Atdheut e Kombit Ali Ahmeti, do të shënojë fitore të reja e suksese edhe më të mëdha të partisë së Tij BDI dhe të popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut!

*Lavdi gjakut të derdhur për liri!
Rroftë populli shqiptar!*

Faleminderit
Prishtinë, 12 Mars 2022!



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Gjilani ndahet baras me Llapin, Ballkani shkatërroi Feronikelin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 MARS - Derbi i javës së 25-të në Superligën e Kosovës në futboll mes Gjilanit dhe Llapit ka përfunduar me rezultat 1-1. Trajneri i skuadrës mysafire, Tahir Batatina e ka kritikuar gjyqtarin Gramoz Shala për dështimin e skuadrës së tij. “Na minuta e parë u vërejt një gjyqtar që se meriton me qenë në Superligë, Gramos Shala duhet me i ardhur marrë. Ai ka ardhur me çdo kusht me na mposht, gjithë ata kartonë pa nevojë. Këto pikë na i mori Gramos Shala, jo Gjilani. Çdo kontakt me topin ka qenë faull. Këto pikë Gramosi t'i çon në shtëpi, sa të jam unë ai nuk ka me referu te Llapi. Marre çka ka bërë. Nuk na ka

lënë me luajt futboll. Djemtë kanë bo maksimumin”, ka thënë Batatina. Francisco Rivera shënoi për 0-1, por sulmuesi Shend Kelmendi shënoi një gol të bukur për rezultatin final 1-1. “Sa i përket rezultatin baras nuk jemi të kënaqur, pasi dihet ekipi jonë çfarë objektiva ka. 15 minuta nuk ishin në element dhe pranuan një gol nga një pjesë ku Llapi është i fortë. Pjesa e dytë ishte krejtësisht tjetër. Qarkullim i topit ishte më i mirë, ekipi kërkoi më shumë fitoren. Futbollistët dhanë gjithçka nga vetja, patën angazhim të madhe dhe kërkuan fitoren. Luajtëm një pjesë të dytë të mirë dhe merituan fitoren”, ka thënë ndihmëstrajneri i Gjilanit, Alban Hyseni. Pas kësaj ndeshje, Gjilani ka 48 pikë në

pozitën e katërt me 41 pikë. Ndërsa Malisheva e mposhti Drenicën në Skenderaj (2-3). Në minutën e 18-të, Agron Bruqi e kaloi skuadrën në epërsi, derisa katër minuta pas golit të epërsisë, Genc Hamiti e barazoi rezultatin në 1-1. Në minutat shtesë të pjesës së parë, Malisheva ka rikthyer epërsinë me golin e shënuar nga Hasan Hyseni. Në minutën e 53-të, Drenica sërish arriti të barazon rezultatin me anë të Armend Abazit. Ndërsa goli e fitores për Malishevën e realizoi Xhaka. Pas kësaj fitore Malisheva ngjitet në vendin e gjashtë, ndërsa Drenica në të shtatën, por me pikë të njëjta gjithsej 32. Ndërsa Drita ka ndarë pikët me Dukagjinin duke luajtur pa gola 0-0. Pas këtij barazimi Drita qëndron



në vendin e dytë me 43 pikë, ndërsa Dukagjini në vendin e tetë me 26 pikë. Lideri i renditjes, Ballkani është rikthyer te fitorja pas humbjes së befasishme në mesjavë ndaj Malishevës. Portokallezinjtë shënuan fitore të pritur ndaj skuadrës së fundit në renditje, Feronikelit, me rezultat 6-0. Golat për Ballkanin i shënuan Armend Thaqi (8'), Meriton Korenica (37'), Blend Baftiu (41'), Mevlan Zeka (59') dhe Arbër Potoku (78', 90'+6'). Në anën tjetër, skuadra kampione në fuqi, Prishtina

BKT Superliga

Gjilani - Llapi	1-1
Dukagjini - Drita	0-0
Drenica - Malisheva	2-3
Prishtina - Ulpiana	2-0
Ballkani - Feronikeli	6-0

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	51
2. Gjilani	47
3. Drita	43
4. Llapi	41
5. Prishtina	32
6. Malisheva	32
7. Drenica	32
8. Dukagjini	26
9. Ulpiana	23
10. Feronikeli	11

ka shënuar fitore në duel me Ulpianën, me rezultat 2-0, ndeshje kjo e cila u zhvillua në stadiumin me bari sintetik në Gjilan. Rezultatit e zhblokoi Qëndrim Zyba, në minutën 53-të. Pesë minuta më vonë fitoren e vulosi Gauthier Mankenda. Kjo fitore ia mundëson Prishtinës të stabilizohet në renditje me 32 pikë.

Fitore jetike për 'Vreshtarët', Peja mposhti Bashkimin

RAHOVEC, 13 MARS - KB Rahoveci ka shënuar fitore shumë të rëndësishme, duke mundur Prizrenin 16, me rezultat 95:85 (32:25, 16:21, 19:20, 28:19), në kuadër të xhiros së 22-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por më pas Vreshtarët ishin në një epërsi të lehtë dhe duke parë rëndësinë e ndeshjes, e nisën më mirë, duke e fituar çerekun e parë 32:25. Vendasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke arritur epërsi në dhjetë pikë, 42:32, por prizrenasit nuk dorëzohen dhe ngushtojnë shifrat në 46:44, ndërsa pjesa e parë përfundoi 48:46. Lojë fantastike u zhvillua në periudhën e tretë, ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, por pa arritur shkëputjen e madhe, dhe luftohej për çdo në parket, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 67:66, duke dëshmuar për

rivalitetin e madh. Kjo bëri që dhjetë minutat e fundit të ishin shumë interesante, me shumë aksione të bukura dhe më një atmosferë të jashtëzakonshme në “Mizahir Isma”. Deri tre minuta nga fundi u zhvillua lojë e barabartë, por në momentet vendimtare vendasit ishin më të vëmendshëm, duke triumfuar 95:85. Te Rahoveci u dalluan Ivan Koljeviq me 24 pikë e pesë kërcime, Fisnik Rugova me 19 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime dhe Makol Mawien me 15 pikë, kurse te Prizreni 16 u dalluan Darell Davis me 22 pikë e shtatë kërcime dhe Xavier Cannefax me 18 pikë e gjashtë kërcime. Rahoveci ka tetë fitore e 13 humbje, kurse Prizreni 16 ka 13 fitore e tetë humbje. Peja ka shënuar fitore ndaj Bashkimit me rezultat 61:76 (20:18, 19:20, 7:25, 15:13), në xhiron e 22-të në Art Motion Superligën e Kosovës në

basketboll. Çereku i parë ishte i barabartë, ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, por pa arritur shkëputjen e madhe dhe kjo pjesë përfundon 20:18. Periudhën e dytë më mirë e nisën pejanët që arritën epërsi deri në nëntë pikë, 22:31, por prizrenasit rikthehen shpejt për të ngushtuar shifrat minimalisht 32:33, e më pas kaluan në epërsi 39:35, ndërsa pjesa e parë përfundon 39:38. Perioda e tretë ishte vendimtare në këtë përballje. Vendasit nuk shënojnë për më shumë se pesë minuta, kurse epërsia e verdhezinjve shkoi në dhjetë pikë, 39:49, ndërsa arritën epërsi deri në 17 pikë, 46:73, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit, u zhvillua lojë e barabartë, dhe kjo i mjaftoi Pejës për të triumfuar 61:76. Te Bashkimi u dalluan John Florveus me 13 pikë e 11 kërcime dhe Valon Bunjaku me



18 pikë, kurse te Peja u dalluan Courtney Fellsme 16 pikë, gjashtë kërcime, gjashtë asistime, Dardan Berisha me 23 pikë dhe Calvin Godfrey me 13 pikë e 11 kërcime. Bashkimi ka nëntë fitore e 13 humbje, kurse Peja ka 14 fitore e shtatë humbje. Trepça ka fituar derbin e xhiros së 22-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll, duke mundur Golden Eagle Yllin në udhëtim me shifrat 63:67 (8:18, 15:9, 14:19, 26:21). Sigal Prishtina ka shënuar fitore të lehtë ndaj Dritës me rezultat 145:45 (33:7, 22:6, 50:14, 40:18), në xhiron e 22-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll.

Muhamet Ramadani fiton medalje të argjendtë në Kupën Evropiane



PRISHTINË, 13 MARS - Atleti i Kosovës, Muhamet Ramadani, ka fituar medaljen e argjendtë në Kupën Evropiane të Atletikës në hedhje për U23. Atleti mitrovicas hedhi gjylen 7 kilogramësh prej 18.60 metra. Kampion i grupmohës U23 u shpall atleti nga Turqia, Alperen Karahan, me hedhje prej 19.81 metra. Kupa Evropiane e Atletikës është duke u mbajtur në Leiria të Portugalisë.

Besa fiton bindshëm përballjen me Prishtinën

PEJË, 13 MARS - Besa Famgas nuk po ka të ndalur në Superligën A të hendbollistëve. Ndonëse të shtunën u takua me skuadrën e dytë në tabelë, Besa shënoi tjetër fitore

bindëse. Ndeshjen me Prishtinën, të zhvilluar në palestrën “Karagaçi” në Pejë, Besa e fitoi me rezultat 44:27. Vetëm minutat e parë të takimit ishin të barabartë. Më pas

vendasit u shkëputën dhe shënuan fitoren e 20-të rresht në këtë kampionat. Besa udhëheq në tabelë me 40 pikë. Prishtina është e dyta me 33 pikë. Kastriot Jupa me 8 dhe Deniz

Terziqi e Egzon Gjuka me nga 7 gola ishin më efikas te Besa Famgas. Oltion Beshiri ishte më efikas te Prishtina me 11 gola. 7 i realizoi Lulzim Shabani.





K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të vendimit të datës 10.03.2022 nga KE, sugjerimit nga Udhëheqësi i Njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve Publike Ministria e Ekonomisë, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 11.03.2022 anulon këtë:

KONKURS

Pozita: Menaxher i njësisë operative, vendi Deçan (1 pozitë), dhe Zyrtar i prokurimit, vendi Pejë (1 pozitë).

Arsyetim

Anulohet konkursi për pozitën Menaxher i Njësisë Operative në Deçan dhe Zyrtar i Prokurimit në Pejë i shpallur në gazetën "Epoka e Re" i datës 01.03.2022. Konkursi anulohet për shkak të gjendjes jo të mire financiare të kompanisë.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Na osnovu odluke EK od 10.03.2022, na predlog šefa Jedinice za praćenje javnih preduzeća, Ministarstvo ekonomije, RKV "Drini i Bardhe" dd, dana 11.03.2022 poništava ovo:

KONKURS

Položaj: Menadžer operative jednice, Dečani (1 pozicija), i Službenik za nabavke, Peć (1 pozicija).

Rasudiavanje

Konkurs za poziciju menadžera operative jednice u Dečanima i službenika nabavke u Peći, objavljen u novinama "Epoka e Re" od 01.03.2022, se poništava. Konkurs se poništava zbog lošeg finansijskog stanja preduzeća.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Njoftim për Ankand Publik 03/2022

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar njofton të gjithë të interesuarit për pjesëmarrjen në Ankandin Publik 003-2022 i cili ishte planifikuar që të mbahet me datën 16.03.2022 se ka tërhequra nga shitja pasurinë në nr rendor 2. Seat 6 L- Ibiza viti i prodhimit 2007,dizel, ngjyre e zezë, me targa vendore, e cila është publikuar në ofertën për shitje në shtypin ditor dhe në ueb faqen e MD-se me date 10.03.2022.

Ju njoftojmë se pjesët tjera mbesin si në Ftesën paraprak për Ankandi Publik 03/2022

Ju faleminderit!

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arbër Dakaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë, me nr. të dosjes:136889.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:

044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 12.03.2022
Prishtinë

Në bazë të nenit 8, 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publik, nenit 20 të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të Udhëzimit administrativ të MASHTI nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues |Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, shpall:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës : **Drejtor në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren**

Lloji i vendit të punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i pozitave: Një (1) pozitë

Kategoria funksionale: Nivel drejtues

Koeficienti: 8.4

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar (4 vite)

Qëllimi i vendit të punës: Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor.

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit;
- Hartimi i planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi efikas dhe efektiv i sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimi i kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunimi me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH);
- Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislationit në fuqi;
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregulloret e QB.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo- arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.

Kandidati duhet të posedoj dhe të dëshmoj dokumentet në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë.
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i
- licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të UA, nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues |Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm;
- Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet më lartë, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar në konkurs publik;
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla, përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHTI.

Afati dhe mënyra e aplikimit

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 11.04.2022 deri me 25.04.2022.

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në uebfaqe të MASHTI (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumentet duhet të jenë kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinali do të kërkohet me rastin e intervistimit

Informata të sakta dhe të vërteta konsiderohen vetëm ato informata që dëshmohen me dokumente (jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi)

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen (refuzohen).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datum: 12.03.2022
Priština

Na osnovu člana 8, 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 O javnim službenicima, član 20 Zakona br. 04 / 1-032 O preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo i Administrativno uputstvo MONTI-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javnih edukativno-obrazovnih i osposbljavajućih institucija u Republici Kosovo, Procedure izbora i imenovanja, Završetak ugovora i Privremeno imenovanje, objavljuje:

K O N K U R S
ZA POPUNJAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: **Direktor Resursnog centra za nastavu i savetovanje "Majka Tereza" u Prizren**

Vrsta radnog mesta: Na neodređeno, puno radno vreme

Broj pozicija: Jedna (1)

Funkcionalna kategorija: Upravni nivo

Koeficijent 8,4

Period imenovanja: NA određeno vreme (4 godin)

Cilj radnog mesta: Rukovođenje, menadžiranje i nadzor edukativno-obrazovne institucije

GLAVNI RADNI ZADACI

- Opšte menadžiranje i upravljanje institucije;
- Izrada godišnjeg plana rada i razvojnog plana obrazovne institucije i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za menadžiranje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka u toku školske godine;
- Zadaci određeni za izbor nastavnika, ocenjivanje, disciplina u Edukativno-obrazovnoj instituciji i druga pitanja u vezi sa nastavnicima i drugim radnicima u obrazovanju;
- Podrška i nadgledanje sprovođenje kurikuluma;
- Podržavanje i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika u edukativno-obrazovno institucije, kao i drugih mehanizama obrazovne institucije koji imaju ulogu u vrednovanju performanse i menadžiranje kvalitet rada institucije;
- Saraduje sa upravnim savetom edukativno-obrazovne institucije (ŠUO),
- Savet roditelja, Savet nastavnika, Savet učenika i zajednica edukativno-obrazovne institucije;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje ispred ŠUO;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu / učenike, uključujući izricanje i primena disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa važećim zakonima;
- Očuvanje dokumenata i podataka, kao što je predviđeno od strane opštine ili Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije (MONI);
- Ostala pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima odobreno od strane MONTI-a i obaveze koje proizilaze iz pravilnika RC.

Opšti zahtevi za prijem javnih službenika

- Da su državljani Republike Kosovo;
- Imaju punu sposobnost da deluje;
- Da govori jedna od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je sposoban u zdravstvenom pogledu sposoban da izvrši odgovarajući zadatak;
- Da nije pravnosnažnom presudom kažnjavan za izvršeno krivično delo;
- Da nema disciplinsku meru koja je na snazi za razrešenje sa funkcije javnog službenika, razrešenog po zakonu.

Uslovi i kriterijumi za izbor kandidata:

- Imaju ima završeno fakultetsko obrazovanje nivo: Master za rukovođenju administriranje ili menadžiranje u obrazovanju (kvalifikaciju od 300 ECTS najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Master obrazovni (kvalifikacija od 300 ECTS / 5 godina univerzitetskog školovanja);
- Četiri godine (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog školovanja);
- Bachelor četverogodišnji (kvalifikacija 240 ECTS / 4 godine univerzitetskog obrazovanja)
- Da ima redovnu licencu za nastavnika u skladu sa uputstvom za licenciranje nastavnika;
- Da je uspešno završio akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžiranje u obrazovanje, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrene od strane MONTI prema preporuka DSLN;
- Da ima radno iskustvo u edukativno-obrazovnom procesu prema smernicama navedenim u radnom katalogu;
- Pet (5) godine radnog iskustva u edukativno-obrazovnom procesu za kandidate za direktore u više srednje obrazovanje;

kandidat mora da poseduje i da dokaže sledeća dokumenta:

- Diploma o završenom fakultetu za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Sertifikat o uspešnom završetku program treninga za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, zasnovano na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu,
- Kandidat/kinja koji ima završen univerzitetski program Master za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, (u nedostatku sertifikata o završenoj obuci za rukovođenje u obrazovanju kandidat/kinja, dostavlja kao dokaz diplomu Master rukovođenja.
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveni karton izdat poslednja šest meseca od strane određene licencirane zdravstvene institucije kojim dokazuje njegovo/njeno zdravstveno stanje;
- Dokaz da kandidat nije pod istragom i dokaz da nije osuđivan/a za zločine, nasilje ili nedostojna dela kojima su obuhvaćena deca;
- Dokaz o radnom iskustvu u edukativno-obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da u poslednje tri godine kandidat nije bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija.
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputstvima u prilogu / obrascu H, br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne edukativno-obrazovne i osposbljavajuće institucije u Republici Kosovo, Procedurama za izbor i imenovanje, Završetak ugovora i privremenom imenovanju.
- Dokumentacija za prijavljivanje je definisana gore, dostavlja se u štampanoj formi kancelariji u roku utvrđenom na javnom konkursu.
- Kandidat/kinja na javnom konkursu ima pravo da se aplicira u jednoj ili više škola. U takvim slučajevima priprema posebno odvojeno dokumentaciju za svaku školu u koju aplicira.
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju da izvrše nostrifikaciju diplome u MONTI.

Rok i način apliciranja

30 dana od dana objavljivanja konkursa ostaje samo obaveštenje, dok konkurs ostaje otvoren 15 dana, aplikacije se podnose od 11.04.2022 do 25.04.2022 .

Popunjeni obrazac za apliciranje (dobija se na web stranici MONTI-a (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumenti moraju biti kopije jer se ne vraćaju, dok će original biti potreban tokom intervjuja

Tačne i istinite informacije smatraju se samo one informacije koje su dokazane dokumentima (a ne oni koji su deklarirani bez dokaza)

Kandidati moraju dostaviti dokumenta Ministarstvu obrazovanj, nauke, tehnologije i inovacije.

Aplikacije dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune aplikacije neće se razmatrati (biće odbijene).



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

